



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.321/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Adnan Konushevci dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fatjona Bekteshi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lista Serbe me seli në Mitrovicë të Veriut, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, në ditën e zgjedhjeve, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.10.2019, mori këtë:

### V E N D I M

**Pranohet** e bazuar ankesa Anr.321/2019, e datës 06.10.2019, e paraqitur nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, subjektit politik Lista Serbe me seli në Mitrovicë të Veriut, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, në ditën e zgjedhjeve – postimi në rrjetin social facebook i shqiptohet gjobë, në lartësi prej 400.00 ( katërqind) euro dhe Detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

### A r s y e t i m

Me datë 06.10.2019, PZAP-i, ka pranuar ankesën Anr.321/2019, nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lista Serbe me seli në Mitrovicë të Veriut, me të cilën ka pretenduar, se përmes faqes në facebook të titulluar “Srpska Lista Novo Brdo”, dje në orën 20:44 ka postuar një mesazh ku bëhet thirrje të votohet Lista Serbe me këtë përmbajtje: “Zavrnsni sastanak aktivista Srpske Liste Novo Brdo u G. Kuscuu!!!”, “Do Pobede 135”. Po ashtu, subjekti i njejtë në orën 07:49 të ditës së djeshme ka publikuar në faqen e njejtë në facebook mesazhin me përmbajtjen: “Zavrnsni sastanak aktivista u stabu Srpske Liste Novo Brdo”, “Do Pobede 135”, me këto veprime, subjekti në fjalë ka vepruar në kundërshtim me Ligjin e Zgjedhjeve, rregullat zgjedhore dhe Kodin e Mirësjelles së Partive Politike. Paraqitësi i ankesës si provë për pretendimet e tij ka bashkangjitur ankesës dy fotografi lidhur me rastin në fjalë.

PZAP-i, më datë 06.10.2019, konform nenit 7 par.1 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e njoftoi subjektin politik Lista Serbe, për ankesën e paraqitur, duke i dhënë kohë të përgjigjet deri më datë 07.10.2019 në ora 13:00, mirëpo të njejtit nuk janë përgjigjur brenda afatit të caktuar kohor.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

#### **Ankesa është e bazuar**

Paneli, konform dispozitës në nenit 8 par.5 të rregullës 02/2015 “Rregullave dhe Procedurave” të PZAP-it, ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës (pasi që provat e ofruara nga i njejtë janë të mangëta) dhe gjeti se të njejtat janë të bazuara,

për faktin se në llogarinë zyrtare në Facebook të subjektit të lartëcekur, ashtu siç pretendon paraqitësi i ankesës, në ditën e heshtjes zgjedhore dhe në ditën e votimit ka postuar fotografi të mbledhjes përfundimtare të aktivistëve dhe të shtabit të tyre, duke bërë thirrje për të votuar Listën Serbe, ku me këtë veprim kanë bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Andaj PZAP-i, duke marr parasysh këtë, si dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së, konstaton se subjekti politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicë të Veriut, është përgjegjës për veprimet e tij, pasi që me veprimet e lartëcekura ka shkelur nenin 36 paragrafi 1 pika b) të LZP-së, që përcakton veprimet e ndaluara para procesit të votimit ku thuhet se *“njezëtekatër (24) orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja e fushatës në çfarëdo mënyre”*.

Paneli mbi bazën e të dhënave të lartëcekura e në mbështetje të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
Anr.321/2019 më datë 07.10.2019

**Kryesuesja e Panelit**  
Gyltene Sylejmani

**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*

